

7-9



## VENDIM

Nr. 11 datë 10.10.2016

### Për

### procedurat e aplikimeve dhe të regjistrimeve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë në Universitetin e Arteve, viti akademik 2016-2017

Bazuar në nenet 40 dhe 76 të ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Udhëzimit nr. 24, datë 07.10.2016, për "Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016" Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2016 – 2017, të ndryshuar, në mbledhjen e zhvilluar në datë 10 Tetor 2016, Rektorati i Universitetit të Arteve:

### VENDOSI

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, nga data **10 Tetor 2016** deri më datën **20 Tetor 2016**.
2. Brenda datës **24 Tetor 2016**, njësitë kryesore përkatëse të shpallin dhe të afishojnë, në vende të dukshme si dhe në faqen zyrtare Web të Universitetit të Arteve, listat e aplikantëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimit dhe kriteret e miratuara nga Senati Akademik.
3. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga datat **24 Tetor 2016** deri në datën **28 Tetor 2016**, pranë sekretarive mësimore përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI  
Prof. Kastriot ÇAUSHI  
UNIVERSITETI I ARTEVE